



STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“LEAL” sh.p.k

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

NENI 1

EMRI

Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet **“LEAL” sh.p.k** e cila ketu e me poshte do te quhet “Shoqeria”. Ajo krijohet nga ortakut i vetem themeluesi **Osman Shehu**

NENI 2

FORMA

2.1 Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 3

BAZA JURIDIKE

3.1 Shoqeria krijohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 4

SELIA

4.1 Selia ndodhet ne Lushnje, RR Kongresi i Lushnjes, nr 6.. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te ortakut te vetem.
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te ortakut te vetem.

NENI 5

TERRITORI


5.1 Shoqeria e zhvillon aktivitetin si ne territorin e Republikes se Shqiperise ashtu edhe jashte saj. Shoqeria mund te krijojte dege (filiale) ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

1. Pastrim
2. Studimi, projektimi zbatimi i punimeve te ndertimit ne perputhje me licencen profesionale
3. Ne fushen e prodhimit te materialeve te ndertimit.
4. Si dhe ne fusha te tjera te veprimtarise tregtare.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.



**NENI 7
KOHEZGJATJA**

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

**KAPITULLI III
AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISE, KONFIDENCIALITETI**

**NENI 8
FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT**

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gezon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

**NENI 9
LIBRI I SHOQËRISE**

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

**NENI 10
KONFIDENCIALITETI**

10.1 Ortaku i vetëm si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qellimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**NENI 11
DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETET**

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga Shoqëria dhe janë të destinuar për të tretet, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshem emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K", si dhe emrin e administratorit.

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRANSFERIMI I TYRE


**NENI 12
KAPITALI THEMELTAR**

12.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 Leke**.

12.2 Ky kapital është teresisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetëm. Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varesi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

**NENI 13
KONTRIBUTET**

13.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë **Osman Shehu**, në vlerën **100 000 Leke**.



NENI 14
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

14.1 Kapitali themeltar është i ndare në 100 pjesë plotesisht të shlyera, secila me vlerë nominale 1000 Leke, të renditura sipas numrit të serise nga 1 në 100.

NENI 15
LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

15.1 Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortakut i vetëm vendos për këtë. Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar është i transferueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkeshortja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të behen ortak nepermjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar, me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas kushteve që lejohen me ligj.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohen me një akt noterial.

ORGANI DREJTUES

NENI 16
ORTAKU I VETEM


16.1 Ortaku i Vetëm ushtron i vetëm të gjitha kompetencat që i njihen me ligj për shkak të kësaj cilesie.

NENI 17
KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

17.1 Për sa kohë që Shoqëria do të përbehet nga një ortak i vetëm, kompetencat e tij do të jenë:

- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektore të vecante të veprimtarisë.
- Vendos për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit dhe transferimin e pjesëve të kapitalit.
- Vendos për politiken afariste të Shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së saj.
- Emeron dhe shkarkon administratoren e Shoqërisë dhe detajon kompetencat e tyre të përcaktuara në statut dhe sipas rastit Ekspertin Kontabel.
- Shqyrton bilancin vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për marrjen e kredive.
- Vendos për krijimin e degeve (filialeve) ose të perfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizike apo juridike.
- Vendos për marrëdhëniet me të rëndësishme ekonomike dhe financiare të Shoqërisë me persona të tjerë fizike apo juridike, vendas apo të huaj.
- Vendos për mbarimin e Shoqërisë, likuidimin e saj si dhe për shndërrimin e Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera.
- Vendos cmimet e mallrave.
- Vendos për pagat e të punësuarëve në Shoqëri.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE
NENI 18
ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ



18.1 Kompetencat e administratorit ose te administratoreve, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne keto akt, administratori ka edhe keto kompetenca:

- Realizon administrimin, drejtimin dhe perfaqesimin e Shoqerise ne marredheniet me persona te tjere juridike apo fizike;
- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Ortakut te Vetem per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri.
- Shqyrton ofertat dhe pergatit kerkesa te cilat ia paraqet Ortakut te Vetem per miratim.
- Ndjek problemet e Shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Ortakut te Vetem te Shoqerise cmimet e mallrave, si dhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.
- I propozon Ortakut te Vetem rregulloret per sektore te vecante te Shoqerise.

18.2 Emerimi i administratorit behet per nje periudhe pa afat, me te drejte rizgjedhje.

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, DIVIDENTET

NENI 19

LIBRAT E SHOQERISE

19.1 Shoqeria eshte e detyruar te mbaje, pervec Librit te Shoqerise ne te cilin shenohet emri i plote i ortakut dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut te vetem, edhe dokumentacionin kontabel dhe librat e tjere.

NENI 20

BILANCI

20.1 Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

20.2 Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel, miratohen nga ortakut i vetem.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 21

DIVIDENTET

21.1 Ortaku i vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Ai percakton fitimin e vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per: rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete ortakut; fondet e tjera qe shihen te nevojshme dhe, nga ana tjetere i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Keshtu ortakut i vetem percakton dhe dividentin.

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 22

MBARIMI

22.1 Shoqeria mbaron me vendim te ortakut te vetem ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

NENI 23
LIKUJDIMI

23.1 Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaku cakton nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit, ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit. Mbas pagimit te kreditoreve ortaku i vetem mban pjesen e mbetur te kapitalit.

MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT

NENI 24

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

24.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do t'i paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente shqiptare.

NENI 25

DISPOZITA E FUNDIT

25.1 Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashte Shqiperise.

25.2 Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e te ciles do te percaktohen nga Ortaku i Vetem.

25.3 Administratori i shoqerise eshte z Osman Shehu. Ai qendron ne kete detyre per nje periudhe pa afat.

25.4 Ky Statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje, ne gjuhen shqipe, duke patur secila fuqi te njejte ligjore.

ORTAKU I VETEM

Osman Shehu.

